

KËRKESË
Nr.1467/1, datë 17.4.2009
PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi rrugës nacionale të Saukut.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr.872, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë, apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Pronarët, për të cilët, në kolonën “Shënime” në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP”, do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë, pronë private, për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 407 931 (katërqind e shtatë mijë e nëntëqind e tridhjetë e një) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE,
TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
Sokol Olldashi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE, TRANSPORTIT DHE TELEKOMUNIKACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË RRUGËS NACIONALE “SAUK”
FSHATRAT: SAUK, MJULL BATHORE, FARKË E VOGËL

Nr.	Pronari	ZK.	Nr. Pas	Arë			Truall			Vlera totale lekë	Shënime
	Emri, Atësia, Mbiemri			Sip.m ²	Çmimi m ²	Vlera lekë	Sip. m ²	Çmimi m ²	Vlera lekë		
1	Fatos Selman Brahja	3266	27/3	134	395	52930				52930	Konfirmuar nga ZRPP
2	Halit Nuredin Brahja	3266	27/4	37	395	14615				14615	Konfirmuar nga ZRPP
3	Genc Etem Brahja	3266	27/2	30	395	11850				11850	Konfirmuar nga ZRPP
4	Xenita Hasan Farka	2704	198/7				12	2517	30204	30204	Konfirmuar nga ZRPP
5	Xhelal Mustafa Metani	2704	193/9/3				20	2517	50340	50340	Konfirmuar nga ZRPP
6	Tire Mustafa Bathorja	2704	193/10				22	2517	55374	55374	Konfirmuar nga ZRPP
7	Dashamir+Izet Shyqyri Osma	2704	206/16	23	344	7912				7912	Konfirmuar nga ZRPP
8	Trashëgimtarët Gjuzi	2704	206/20	13	344	4472				4472	Konfirmuar nga ZRPP
9	Lumturi Gjuzi	2704	206/19	74	344	25456				25456	Konfirmuar nga ZRPP
10	Bashkëpronarët Allaraj+Hoxha	2704	230/13	262	344	90128				90128	Konfirmuar nga ZRPP
11	Nadire Rrushi	2704	217/18				18	2517	45306	45306	Konfirmuar nga ZRPP
12	Agim Sali Muharremi	1605	211/23	52	372	19344				19344	Konfirmuar nga ZRPP
	TOTALI			201		79395	72		181224	407931	

